



Kolegji ESLG

Rregullore e Punës e Senatit të Kolegjit

Neni 1

Me këtë rregullore, përcaktohen anëtarët e Senatit, mënyra e përfaqësimit të tyre në Senat, mënyra e punës dhe e marrjes së vendimeve në mbledhjet e Senatit të Kolegjit.

Neni 2

Senati i Kolegjit përbëhet nga së paku nëntë anëtarë:

1. Rektorit;
2. Prorektorëve;
3. Drejtorët e departamenteve;
4. Një anëtar i zgjedhur nga stafi akademik i secilës njësi akademike;
5. Një përfaqësues i këshillit të studentëve dhe
6. Një anëtar nga stafi teknik-administrativ.

Neni 3

Përfaqësuesi i Këshillit të studentëve, Rektori dhe së paku një prorektor janë anëtarë ex officio të Senatit.

Neni 4

Anëtarët e Senatit nga stafi akademik zgjidhen nga Këshilli Akademik.

Neni 5

Senati duhet të mbajë së paku dy mbledhje të rregullta gjatë një semestri, një në fillim dhe një në fund të semestrit. Senati mund të mbajë më shumë mbledhje, varësisht nga intensiteti i punëve.

Neni 6

Anëtarët e Senatit obligohen të marrin pjesë në mbledhjet e senatit. Një anëtar i Bordit të Kolegjit gjithashtu mund të marrë pjesë në mbledhjet e Senatit, por pa të drejtë vote.

Nazim Gafurri 33 Prishtinë Republika e Kosovës

T: +383 38 602 405

T: +383 44 159 867

E: info@eukos.org

W: www.eukos.org



Kolegji ESLG

Neni 7

Rektori i Kolegjit thërret mbledhjet e rregullta të Senatit. Mbledhjet e jashtëzakonshme po ashtu thirren nga Rektori sipas kërkesës së Drejtorit të departamentit apo programit të studimit të anëtarëve të Senatit.

Neni 8

Mbledhjet e Senatit mund të mbahen nëse në to marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të Senatit.

Vendimet e Senatit merren me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm.

Neni 10

Mbledhjet e Senatit përgatiten dhe udhëhiqen nga Rektori i Kolegjit.

Neni 11

Pas verifikimit të numrit të anëtarëve prezentë dhe pas konstatimit të ekzistimit të më tepër se gjysmës së anëtarëve të Senatit, Rektori shpall të hapur mbledhjen e Senatit, cakton procesmbajtësin dhe propozon rendin e ditës.

Neni 12

Pas propozimit të rendit të ditës, Rektori pyet anëtarët e tjerë nëse kanë propozime për të plotësuar apo ndryshuar rendin e ditës. Rendi i ditës miratohet nga Senati me shumicën e thjeshtë.

Neni 13

Gjatë diskutimeve në pika të ndryshme të rendit të ditës, anëtarët duhet të shqyrtojnë të gjitha çështjet që diskutohen në mënyrë të arsyeshme. Rektori është personi përgjegjës për t'ia dhënë fjalën diskutuesit.



Kolegji ESLG

Neni 14

Senati nxjerr opinione të ekspertëve në lidhje me programet e reja dhe ndryshimet e programeve ekzistuese.

Neni 15

Vendimet e Senatit, të cilat mund të bëhen vetëm me pëlqimin paraprak të Bordit, janë të gjitha ato vendime, të cilat kanë ndikim financiar, duke përfshirë edhe ato për regjistrimin e studentëve edhe punësimin dhe shkarkimin e personelit akademik.

Ndryshimet dhe çështjet të tjera rregullohen në të njëjtën mënyrë dhe procedurë.

Neni 16

Rregullorja hyn në fuqi pas miratimit nga anëtarët e Senatit të Kolegjit.

20.08.2019

Presidenti i Bordit Menaxhues

Prof. Dr. Edmond Hajrizi



